



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA E TIRANËS
KLUBI SPORTIV TIRANA
SEKTORI ADMINISTRATIV DHE LIGJOR**

Formulari Nr. 3

Tiranë më 16.08.2024

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri : Klubi Sportiv Tirana
Adresa : “Rr.Kavajës”, Palestra “Fahrie Hoti”
e-mail : prokurimekst@tirana.al
Adresa e internetit : www.kstirana.al

Autoriteti Kontraktor **Klubi Sportiv Tirana** do të zhvillojë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, për sa më poshtë :

Me objekt: **“Blerje biletë transporti ajror ndërkombëtar me destinacion” :**

Tiranë –Zagreb – Split -Tiranë. (vajtje-ardhje)

Data e zhvillimit do të jetë **16/08/2024** ora **13:30** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna :

1. Biletat janë me itinerarin, Tiranë –Zagreb- Split- Tiranë për 1 (një person)

- Nisja nga Tirana drejt Zagreb-it do të bëhet në datën 20.08.2024, në drekë dhe mbërritja në Zagreb para orës 18.20

Nisja nga Zagrebi drejt Split-it do të bëhet në datën 22.08.2024 ora 14:40

- Kthimi nga Spliti drejt Tiranës do të bëhet në datën 23.08.2024 nisja të bëhet mbasdite

***Udhëtim direkt, me bagazh të përfshirë.**

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

a) **Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.**

**Operatori Ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit Ekonomik.*

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKB, objektin e prokurimit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë biletën elektronikisht në e-mail: prokurimekst@tirana.al brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Me marrjen e njoftimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor KST për realizimin apo pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, brenda 2 (dy) orëve nga momenti i njoftimit të operatorit nga Komisioni i sistemit dinamik të biletave. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Në rast se ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor KST në "Ftesën për ofertë" do të përzgjidhet ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur e fundit të mbetur në klasifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentave: Brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.